

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 16701/19

Fatmir HOXHA

kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 15 tetor 2024 si Komitet i përbërë nga:

Ioannis Ktistakis, *kryetar*,

Darian Pavli,

Andreas Zünd, *gjyqtarë*,

dhe Olga Chernishova, *zëvendëskancelare e Seksionit*,

duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 16701/19) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("Konventa") më 11 mars 2019 nga shtetasi shqiptar z. Fatmir Hoxha ("kërkuesi"), i lindur në vitin 1968, me banim në Tiranë dhe i përfaqësuar nga z. E. Mërkuri, avokat i licencuar në Tiranë;

vendimin për të njoftuar qeverinë e Shqipërisë ("Qeveria") të përfaqësuar nga z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit, për ankimet në lidhje me të drejtën për seancë dëgjimore të drejtë dhe për të shpallur të papranueshme pjesën tjetër të kërkesës;

parashtrimet e depozituara nga Qeveria e paditur dhe prapësimet e paraqitura nga kërkuesi;

komentet e depozituara nga Res Publica që u pranuan për ndërhyrje nga kryetari i Seksionit;

pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me procedurat e vetingut që rezultuan në shkarkimin e kërkuesit nga gjyqësori.

2. Kërkuesi ka qenë gjyqtar që në vitin 1991 dhe së fundmi gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë. Në vitin 2011 ai bleu një apartament në Tiranë. Si subjekt i deklarimit periodik të pasurisë dhe interesave të tjerë privatë që në vitin 2003, në deklaratën e tij të vitit 2011 ai deklaroi një hua të marrë në shumën 28,500 euro në shkurt 2011 nga A.G., kunati i tij, për financimin e blerjes.

3. Në kuadër të procesit të vetingut përpara Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK) dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelit (KPA) (shihni *Xboxhaj kundër Shqipërisë*, nr. 15227/19, 9 shkurt 2021), në vitin 2017 kërkuesi e deklaroi atë apartament në deklaratën e pasurisë për vetingun si të blerë me kredi bankare të konsiderueshme, të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes së tij dhe të ardhura nga shitja e një apartamenti tjetër.

4. KPK-ja kërkoi që A.G. të provonte edhe faktin e huas dhe "*ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të dhëna hua*". Sipas përgjigjeve të A.G. në marrjen në pyetje nga KPK-ja në shkurt 2018, fondet ishin gjeneruar përmes kursimeve nga veprimtaritë e tij fitimprurëse nga 1994-ta deri më 1997-n që kishin të bënin me importimin e mallrave të dorës së dytë (si veshje dhe automjete) nga Italia (shihni edhe paragrafin 10 më poshtë.) Kur u pyet nëse ishte "regjistruar" tek autoritetet për veprimtari tregtare fitimprurëse, A.G. u shpreh, në thelb, që kishte operuar si person fizik, për importin sipas rregullave në fuqi për nevojat personale dhe kishte paguar "taksën e peshës" në doganë. Në vitin 2011 ai kishte tërhequr paratë nga llogaria bankare dhe ia kishte dhënë motrës (bashkëshortja e kërkuesit) me qëllim blerjen e apartamentit. Kur iu kërkua që të paraqiste dokumentet përkatëse, A.G. u shpreh që nuk i kishte më dhe e ftoi KPK-në që t'u bënte kërkesë doganave dhe autoriteteve të tjera.

5. KPK-ja i dërgoi një pyetësor kërkuesit ku e pyeste nëse huaja nga A.G. kishte qenë burim për blerjen e apartamentit, siç tregohet në deklaratën e tij të vitit 2011, dhe i kërkoi që të paraqiste të gjitha dokumentet përkatëse për të marrë dhe ripaguar huan. Kërkuesi u përgjigj që huaja ishte përdorur për të blerë apartamentin; që për shkak të marrëdhënieve familjare nuk ishte lidhur një kontratë me shkrim; dhe që ai e kishte paguar huan me këste nga 2011-ta deri në 2014-n.

6. Në përfundim të hetimit, më 19 mars 2018, KPK-ja i dha kërkuesit një raport që lexonte si më poshtë:

“Huaja e marrë nga kunati juaj [A.G.], nuk u deklarua në deklaratën e vetingut si një nga burimet [për blerjen e apartamentit] ... në përgjigje të pyetjes sonë [ju u shprehët]: “Huaja e marrë nga kunati ... ishte një nga burimet e përdorura për blerjen...”

7. Më pas, KPK-ja e kaloi barrën e provës te kërkuesi në lidhje me pasuritë e përmendura në raport dhe i dha një afat për t’u përgjigjur dhe paraqitur dokumentet mbështetëse. Kërkuesi u njoh me dosjen e çështjes, përfshirë dëshminë e A.G. (shihni paragrafin 4 më lart).

8. Kërkuesi u përfaqësua nga avokati në seancën dëgjimore përpara KPK-së. Relatori i KPK-së theksoi se hetimi i KPK-së ishte fokusuar në burimin e ligjshëm të të ardhurave për apartamentin dhe që kërkuesi kishte marrë rezultatet e hetimit paraprak, në lidhje me një person tjetër dhe origjinën e të ardhurave të tij gjatë viteve. Avokati i kërkuesit nuk pati pyetje në lidhje me objektin e çështjes në këtë pikë.

9. Me vendimin e 10 majit 2018, KPK-ja, me shumicë votash e shkarkoi kërkuesin nga detyra. Në lidhje me huan e marrë nga A.G., KPK vlerësoi se: i. në deklaratën e vitit 2011 kërkuesi ka deklaruar huan si burim për blerjen e apartamentit; ii. ai nuk ka deklaruar atë hua si burim në deklaratën e vetingut; iii. për gjetjen e ligjshmërisë së burimeve për atë pasuri A.G. ishte “personi i lidhur” i kërkuesit sipas kuptimit të nenit 3 (14) të ligjit për vetingun (LV); iv. ai nuk e justifikoi origjinën e ligjshme të parave sipas kërkesës së nenit 32 (4) të LV-së; v. A.G. iu referua vërtetimeve bankare dhe u shpreh që nuk ishte regjistruar pranë autoriteteve tatimore dhe nuk kishte paguar taksat. Kështu kërkuesi ka bërë “deklarim të pamjaftueshëm”, sipas kuptimit të nenit 61 (3) të LV-së dhe nuk ka treguar në mënyrë bindëse burimin e ligjshëm sipas nenit D § 3 të aneksit të Kushtetutës.

10. Kërkuesi e ankimoi vendimin në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (KPA), duke pretenduar *inter alia* se ai kishte deklaruar huan në deklaratimet e tij periodike nga 2012 deri në kthimin e saj dhe se ai nuk e kishte deklaruar në deklaratën e vetingut, sepse deri më 2017-n ai e kishte paguar tashmë dhe prandaj nuk mund të konsiderohej si detyrim financiar ekzistues që duhej deklaruar. Ai kërkoi të sjellë në prova dokumente si pasaporta e A.G. e lëshuar në vitin 1996; kontrata e tij e depozitës bankare në 2010 për 2,500 euro; një shkresë e 13 qershorit 2018 nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me të dhëna të lëvizjes së tij nga viti 2004 deri më 2010-n; dhe dokumente në lidhje me shitjen e automjeteve ndërmjet 2004-s dhe 2009-s (shihni edhe paragrafin 4 më lart).

11. Më 28 shtator 2018, KPK-ja shqyrtoi ankimin dhe la në fuqi, me shumicë votash, vendimin e KPK-së. KPA-ja, mbështetur në rregulloren e saj të brendshme, refuzoi të pranojë prova shtesë të paraqitura nga kërkuesi, duke pretenduar se kërkuesi duhej t’i kishte paraqitur gjatë seancave përpara KPK-së dhe nuk e kishte justifikuar bindshëm mosparaqitjen e tyre. KPA-ja vlerësoi se megjë KPK-ja kishte përcaktuar faktet si duhej, nuk ishte e nevojshme seancë me gojë përpara KPA-së; provat e reja ishin pa vend ose jovendimtare, sipas kuptimit të nenit 49 (6) (b) të LV-së.

12. Më tej vlerësoi se gjatë plotësimit të deklaratës së vetingut në vitin 2017, kërkuesi duhej të kishte kuptuar, se: i. në vitin 2011 huaja kishte qenë një nga burimet për blerjen e apartamentit dhe prandaj duhej të deklarohej në deklaratën e vetingut; ii. kërkuesi dhe A.G. kishin detyrimin sipas nenit D § 3 të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32 (1) dhe (4) të LV-së të justifikonin – edhe në deklaratën e vetingut edhe gjatë proceseve – origjinën e ligjshme të 28,500 eurove; dhe iii. ata duhej ta bënë këtë pavarësisht nëse KPK-ja e kishte ngritur çështjen gjatë hetimit ose në raportin e tij përfundimtar.

VLERËSIMI I GJYKATËS

A. Objekti i çështjes

13. Në formularin e kërkesës së tij në vitin 2019, kërkuesi u ankua sipas nenit 6 të Konventës që nuk kishte pasur një seancë dëgjimore të drejtë. Sidomos, ishin cenuar e drejta e tij për t'u njohur, për të bërë parashtrime dhe për të dhënë prova për çështjet në themel të përfundimeve të arritura nga KPA-ja, veçanërisht për huan nga A.G. dhe në lidhje me barrën e provës në atë drejtim. Në vitin 2023, këto ankime iu komunikuan Qeverisë së paditur, ndërsa pjesa tjetër u shpall e papranueshme. Kërkuesi u informua përkatësisht.

14. Në vitin 2024, në prapësimet e tij ndaj parashtrimeve të Qeverisë për ankimet e komunikuar, kërkuesi: i. shtjelloi ankimet që në thelb ishin të njëjta me ato që ishin shpallur të papranueshme; dhe ii. referoi, për herë të parë, çështje të tjera, të cilat nuk shtjellonin ankimet e komunikuar. Nëse do të kuptohej që kërkuesi synonte t'i referonte Gjykatës pretendime të reja në lidhje me vendimin e KPA-së në vitin 2018, ato nuk u depozituan në përputhje me rregullin 47 §§ 1, 2 dhe 5.1 të Rregullores së Gjykatës. Ato parashtrime janë jashtë objektit të kësaj çështjeje në gjendjen që është dhe Gjykata nuk do t'i shqyrtojë (shihni *Fu Quan, s.r.o kundër Republikës Çeke* [DHM], nr. 24827/14, §§ 137 dhe 144 48, 1 qershor 2023, dhe *Gashi dhe Gina kundër Shqipërisë*, nr. 29943/18, §§ 75 dhe 79, 4 prill 2023).

B. Ankimi sipas paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës

1. Parashtrimet e palëve

15. Qeveria pretendoi se kërkuesi i ishte dhënë mundësia për të paraqitur prova dhe për të kundërshtuar problemet në lidhje me huan në disa raste: gjatë paraqitjes së deklaratës (deklaratave) periodike të pasurisë duke deklaruar burimin e huas; gjatë paraqitjes së deklaratës së vetingut ku ai duhej të deklaronte dhe të provonte burimin e huas; gjatë dhe pas hetimit të KPK-së, gjatë seancës përpara KPK-së dhe përpara KPA-së.

16. Kërkuesi pretendoi se komunikimi ndërmjet KPK-së dhe A.G. mbi të ardhurat e tij nuk justifikonte transferimin tek ai të barrës së provës. Procedura nuk mund të varej nga bashkëpunimi i një pale të tretë për të paraqitur prova në këtë drejtim, sepse ai person mund të mos dëshirojë të bashkëpunojë me subjektin e vetingut për shumë arsye. Raporti i KPK-së nuk iu referua çështjeve faktike apo ligjore për justifikimin e fondeve të A.G. Trupi gjykues nuk e bëri këtë problem objekt diskutimi. KPA-ja nuk korrigjoi atë mangësi procedurale, sepse refuzoi të pranojë provat e dhëna nga kërkuesi.

17. Ndërhyrja nga pala e tretë, *inter alia*, argumentoi që interpretimi dhe zbatimi i saktë i LV-së duhej të tregonte që çdo aktivitet gjenerues i të ardhurave që nuk ishte i paligjshëm duhej të konsiderohej burim i ligjshëm i të ardhurave.

2. Vlerësimi i Gjykatës

18. Kërkuesi ishte palë në procesin me natyrë disiplinore dhe bazuar në gjetjet paraprake, për pikat përkatëse të ligjit dhe faktit, të ngritura fillimisht nga një hetim administrativ (shihni *Thanza kundër Shqipërisë*, nr. 41047/19, § 97, 4 korrik 2023). Atij iu kërkuar që të provonte të kundërtën e atyre gjetjeve, përndryshe ai mund të shkarkohej nga detyra. Prandaj, sipas aspektit civil të paragrafit 1 të nenit 6, në lidhje me “të drejtat dhe detyrimet e tij civile”, atij duhej t'i jepej mundësia e mjaftueshme për të kundërshtuar ato gjetje dhe për të mbrojtur çështjen e tij në mënyrë efektive (ibid., dhe *Sevdari kundër Shqipërisë*, nr. 40662/19, § 122, 13 dhjetor 2022).

19. KPK-ja vlerësoi çështjet në lidhje me huan e konsiderueshme nga A.G., si një shkak i veçantë për shkarkimin e kërkuetit nga detyra. Hetimi për origjinën e fondeve të A.G. ishte ngritur si fillim gjatë hetimit (shihni paragrafin 4 më lart). Kërkuesi u njoh me materialet e rëndësishme, përfshirë intervistën e A.G. me KPK-në. Raporti në përfundim të hetimit iu referua mungesës së informacionit në deklaratën e vetingut për huan, por nuk specifikoi çështjen e ligjshmërisë, përfshirë pagimin e taksave, mes çështjeve për të cilat barra e provës i kaloi kërkuetit (shihni paragrafin 6 më lart). Kërkuesi e ankimoi në KPA, një tribunal me kompetencë të plotë mbi pyetjet e faktit dhe ligjit (shihni *Xboxhaj*, cituar më lart, §§ 286, 334 dhe 416). Çështja e rëndësishme përpara Gjykatës është nëse KPA i dha mundësinë e duhur për të kundërshtuar gjetjet e KPK-së për huan dhe për të mbrojtur çështjen e tij në mënyrë efektive.

20. Së pari, përveç mosdeklarimit të huas nga kërkuesi, ato gjetje u fokusuan në përmbushjen e detyrimeve tatimore të një personi jashtë familjes së ngushtë të subjektit të vetingut (A.G.) për të ardhurat e marra në Shqipëri dhe, për më tepër, për ngjarje që u zhvilluan gjatë një periudhe të konsiderueshme kohe. Megjithatë, në lidhje me barrën e provës sipas aspektit civil të paragrafit 1 të nenit 6 (shihni *Thanza*, § 114; *Sevdari*, § 130; dhe *Xhoxhaj*, §§ 348-49, të gjithë të cituar më lart), elementet vendimtare mbi të cilat KPA-ja vendosi për atë aspekt të çështjes – detyrimi i A.G. për të paguar taksat dhe mospagimi i tyre nga ana e tij – u konsideruan të provuara në thelb në bazë të deklarimeve të vetë A.G., përpara KPK-së. A.G. ishte bashkëpunues me subjektin e vetingut (kërkuesin) dhe organet e vetingut dhe nuk shfaqti pengesë ose armiqësi, duke e ndihmuar atë që të njihej me dokumentet (shihni paragrafin 10 më lart). Në lidhje me shkakun e shkarkimit për ligjshmërinë e fondeve të A.G., KPA-ja e mbështeti shkarkimin e kërkuesit nga detyra në element faktik të pakontestueshëm (mospagimi i taksave), që i bën fondet “e paligjshme” për qëllime të LV-së (krahasoni *Gryaznov kundër Rusisë*, nr. 19673/03, § 61, 12 qershor 2012).

21. Së dyti, për kërkuesin ishte e hapur mundësia që të kundërshtonte faktet dhe të parashtronte argumente ligjore përpara KPA-së, për shembull duke kundërshtuar deklarin e A.G. ose duke kërkuar shtjellimin apo sqarimin e tij të mëtejshëm (shihni paragrafin 4 më lart). Kërkuesi ngriti disa argumente në lidhje me fondet (shihni paragrafin 10 më lart). KPA-ja trajtoi argumentet kryesore dhe mbështeti vendimin e tij në arsyetimin që ishte i njëjtë me kontekstin e veçantë të çështjes (shihni paragrafët 8 dhe 19 më lart) dhe i mjaftueshëm për qëllimet e nenit 6 (shihni *Perez kundër Francës* [DHM], nr. 47287/99, §§ 80-81, GJEDN] 2004-I).

22. Së treti, në lidhje me provat e dhëna nga kërkuesi për të mbështetur pretendimet e tij, KPA-ja refuzoi të pranojë zyrtarisht ato prova në dosje. KPA-ja mbajti qëndrim për relevancën e tyre të largët dhe vlerën e ulët provuese. Prova e dhënë nga kërkuesi, për herë të parë, përpara KPA-së nuk ishte *prima facie* në gjendje të kundërshtonte gjetjet e KPK-së që ai nuk kishte provuar se A.G. kishte paguar taksat për të ardhurat e veprimtarisë së tij tregtare, duke treguar rrjedhimisht ligjshmërinë e fondeve për qëllimet e LV-së. Nisur nga dëshmia e A.G., nuk duket se ndonjë provë shtesë do të mund të kundërshtonte në mënyrë të efektshme këtë gjetje.

23. Në fund, interpretimi nga KPA-ja i deklaratës së A.G., gjetjet e tyre faktike në lidhje me huan, zbatimi i legjislacionit të brendshëm, siç është diskutuar në paragrafët më sipër, dhe trajtimi prej tyre i provave nuk ishte arbitrar apo haptazi i paarsyeshëm, sipas paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës dhe ishte në përputhje me kërkesat e një procesi të drejtë (shihni *Thanza*, § 102; *Sevdari*, §§ 125 dhe 130-31; dhe *Grosam*, §§ 130-32, të gjithë të cituar më lart).

24. Gjykata del në përfundimin se, duke pasur parasysh procesin në tërësi dhe duke vlerësuar drejtësinë e përgjithshme të tij, kërkuesit iu dha mundësia e duhur për të kundërshtuar gjetjet e diskutuara dhe për të mbrojtur çështjen e tij në mënyrë efektive. E drejta e tij për seancë dëgjimore të drejtë sipas aspektit civil të paragrafit 1 të nenit 6 nuk u cenua në rrethanat e çështjes. Nuk duket se ka shkelje të asaj të drejte në lidhje me aspektet e tjera të proceseve të vetingut.

25. Në këto rrethana, ankimet e kërkuesit janë haptazi të pabazuara dhe duhet të refuzohen në përputhje me nenin 35 § 3 (a) dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht:

Shpall kërkesën të papranueshme.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 14 nëntor 2024.

Olga Chernishova
ZËVENDËSKANCELARE

Ioannis Ktistakis
KRYETAR